



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 20 dhjetor 2013  
Nr. ref.:RK527/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI54/13**

Parashtrues

**Gani Alidema**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 177/2010, të 8 janarit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Gani Alidema, nga fshati Pozharan, komuna e Vitisë ( në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi ), të cilin para Gjykatës Kushtetuese e përfaqëson avokati z. Gafur Elshani nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 177/2010, i 8 janarit 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 177/2010, të 8 janarit 2013, e me të cilin, sipas parashtruesit të kërkesës, janë shkelur nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe neni 10 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet: 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 10 prill 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me Vendimin e Kryetarit, Nr. GJR. 54/13, të 16 prillit 2013), gjyqtari Ivan Čukalović u caktua Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, Nr. KSH. KI54/13, u caktua Kolegji shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 5 qershor 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të lëndës me numër KI54/13.
8. Më 16 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Ivan Čukalović i propozoi Kolegjit Shqyrtues, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 22 tetor 2008, B. R. ushtroi padi për konfirmimin e pronësisë në Gjykatën Komunale në Gjilan kundër parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar që të vërtetohet se B. R. është pronar i lokalit afarist nr. 19, i cili gjendet në Gjilan, rr. „Dardania I“ - Qendra Tregtare, kati përdhes, me sipërfaqe 51.21 m<sup>2</sup>, i ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 3299, 3300, 3302, 3304 dhe 3307, ZK Gjilan, në bazë të kontratës për shitblerje.

10. Më 6 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës, paraqiti përgjigje me shkrim ndaj padisë, me të cilën kontestoi kërkesëpadinë e B. R. dhe i propozoi gjykatës të hedhë poshtë kërkesëpadinë si ligjërish të pabazuar.
11. Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktgjykimin C. nr. 564/08, të 28 prillit 2009, miratoi padinë e B. R. dhe konfirmoi se B. R. është pronar i patundshmërisë së lartpërmendur.
12. Kundër aktgjykimit të lartpërmendur, më 18 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, me propozimin që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, C. nr. 564/08, i 28 prillit 2009, dhe ai t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.
13. Duke vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin Ac. nr. 198/2009, të 6 prillit 2010, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 564/08, të 28 prillit 2009.
14. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 198/2009, të 6 prillit 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion, me propozimin që të anulohen aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, dhe atë: Aktgjykimi C. nr. 564/08 i Gjykatës Komunale në Gjilan dhe Aktgjykimi Ac. nr. 198/09 i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, si dhe të kthehet lënda për rishqyrtim dhe për rivendosje.
15. Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin rev. nr. 177/2010, të 1 janarit 2013, refuzoi si të pabazë revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 198/2009, të 6 prillit 2010.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi i kërkesës thekson se nenet 24 (Barazia para Ligjit) dhe 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës, si dhe neni 6 (E Drejta për Proces të Drejtë) i Konventës për të Drejtat e Njeriut e neni 10 (E Drejta e Barabartë për Gjykim të Drejtë dhe Publik) i Deklaratës Universale për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, janë shkelur me këtë aktgjykim të Gjykatës Supreme dhe pretendon si vijon:

*“Parashtruesi i kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ngase palët në procedurë nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, dhe se gjykatat nuk kanë shqyrtuar provat dhe faktet që ka ofruar parashtruesi i kërkesës”.*

17. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, thekson:

*“Me Aktgjykimin e revizionit rev. 177/2010, të 08.01.2013, Gjykata e Revizionit, në faqen 3 të arsyetimit të aktgjykimit thirret në prova të paqena, se kinse parashtruesi i revizionit paska blerë lokalin nr. 13, e jo lokalin nr. 19, edhe pse gjatë tërë procedurës palët ndërgjyqëse kontestin e kanë zhvilluar për lokalin nr. 19”.*

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që

*“Të anulojë të njëjtat aktgjykime dhe të kthejë rastin për rigjykim në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me provat”.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

19. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesja i ka plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë, e qartësohen më tutje me Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës që parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

21. Për më tepër, rregulli 36. (2.b) i Rregullores së punës parasheh se:

*“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”*

22. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës së referuar “... në prova të paqena dhe se kinse parashtruesi i revizionit ka blerë lokalin nr. 13, dhe jo lokalin nr. 19, edhe pse gjatë gjithë procedurës palët ndërgjyqëse kontestin e kanë zhvilluar për lokalin nr. 19“, kanë të bëjnë me vlerësimin e gabuar dhe jo të plotë të provave materiale nga ana e gjykatave të rregullta.

23. Gjykata rikujton se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç kur shkelen të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).

24. Detyrë e Gjykatës, sa u përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave kushtetuese, është që të vlerësojë nëse procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe në pajtueshmëri me masat mbrojtëse të parapara me Kushtetutë. Kështu, pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

25. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz



kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

26. Në këtë rast, nuk ekzistojnë prova *prima facie* se Gjykata Supreme ka vlerësuar në mënyrë të parregullt provat e ofruara nga parashtruesi i kërkesës (Shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 53363/99, i majit 2005). Në fakt, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë se Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur nenin 6 të Konventës për të Drejtat e Njeriut; nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës; si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë prova të duhura me çfarë do të mbështeste pretendimet e tij se Gjykata Supreme dhe organet e tjera gjyqësore i kanë shkelur të drejtat elementare të njeriut, të garantuara me Kushtetutë.
27. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit, dhe me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 tetor 2013, njëzëri

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani